



Pas largimit të Gugash Maganit, Teuta ka bërë zyrtare disa levizje të reja. Trajneri italian Roberto Sorrentino është pasardhësi i tij. Ai ka qenë bashkëpunëtor u ngushtë i të madhit Giovanni Trapatoni të Juventus në sezonet 1991-1995 dhe pritet të sjellë një eksperiencë të re në Durrës tek skuadra e Teutes që ka si qëllim titullin kampion këtë sezon. Bashkë me të, tek "Djemte e Detit" është bërë zyrtare edhe afrimi i kompanisë "Gea Sport" që ka për synim të bëhet aksionere tek Teuta dhe të afroje lojtarë të ndryshëm kryesisht nga Brazili. Me këtë levizje, presidenti Edmond Hasanbelliu ka për qëllim të shtojë kapitalin financiar dhe të jetë së bashku me Skenderbeun në krye të futbollit shqiptar edhe për disa vite të tjera.